

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MET DISTRIBUTION” SHPK

Sot më Datë 28.02.2018, themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Met Distribution”, sipas parashikimeve të këtij Akti Themelimi.

NENI 1

Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Themelohet Shoqëria “Met Distribution” Shpk.
- 1.2 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2

Themeluesit

- 2.1 Ortak themelues të Shoqërisë janë:
Hauard Malo, i biri i Muhametit, lindur më 23.12.1995 në Tiranë dhe banues po aty, mbajtës i Pasaportës me Nr. BB9441725 dhe Nr. Personal J512230470.

NENI 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në Rrugën “Lekë Dukagjini”, Pallati 11, Kati 1, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare, mund të hapi degë të saj në të gjithë territorin e Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do ta ushtroj veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

NENI 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e Importimit dhe Shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve kozmetike me bazë përbërësit natyror.

NENI 6

Kapitali

- 6.1 Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë.
- 6.2 Kapitali i Regjistruar Shoqërisë është i përbërë nga një kuotë përfaqësuese e 100% të kapitalit, e cila zotërohet tërësisht nga Ortaku Themelues Hauard Malo.
- 6.3 E gjithë vlera e kontributit të ortakut për nënshkrimin e kapitalit të regjistruar, është në para.

NENI 7
Organet e Shoqërisë

- 7.1** Organet e Shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme
 - Administratori

NENI 8
Asambleja e Përgjithshme

- 8.1** Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë ushtrohen nga ortaku i vetëm i saj.
- 8.2** Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 8.3** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 9
Emërimi dhe Kompetencat e Administratorit

- 9.1** Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është edhe Administrator i saj.
- 9.2** Afati i emërimit të Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje.

NENI 10
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 10.1** Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Akti Themelimi, kompetente do të jetë Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

ORTAKU THEMELUES

Hauard MALO

Nënshkruar në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë, sot më datë 28.02.2018.

